

PARTNERË NË REFORMA

Përzgjedhje e projekteve të financuara nga BE-ja në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë



Informata plotësuese mbi Bashkimin European mund të gjenden në ueb faqen ec.europa.eu

Lista e të gjitha ueb faqeve të përdorura në këtë broshurë, është në fund të broshurës.

Delegacioni i Bashkimit European
në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë
Mito Haxhivasilev Jasmin 52v.
1000 Shkup
Tel: +389 2 3248 500
Fax: +389 2 3248 501
Email: delegation-fyrmacedonia@ec.europa.eu
www.delmkd.ec.europa.eu

Botuar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë



Nxënëse e shkollës së mesme, luan muzikë klasike me rastin e Ditës së Europës 2010

Parathënie



Ervan Fuere,

Përfaqësues Special i Bashkimit Europian dhe Shef i Delegacionit të Bashkimit Europian në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

Të nderuar lexues,

Për momentin, mbi se 250 projekte të financuara nga BE-ja u përfunduan ose janë duke u implementuar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Duke filluar nga viti 1992 dhe deri në futjen në përdorim të Instrumentit të ri të Ndhmës për para-anëtarësim në vitin 2007 (më tepër e njohur si IPA), ndihma financiare e Bashkimit Europian, e cila distribuohet kryesisht përmes programeve PHARE dhe CARDS, arrinte vlerën e përgjithshme në mbi 800 milionë euro. Ndhma e BE-së, në suaza të programit IPA, ka për qëllim të ndihmojë vendin të përfundojë reformat e planifikuara dhe të domosdoshme për arritjen e anëtarësimin në BE. Ndhma që do të ofrohet në periudhën 2007-2013, me anë të pesë komponenteve të Ndhmës IPA, do të ketë vlerën prej 622.5 (622,496,001) milionë euro. Veç kësaj, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka gjithashtu qasje edhe në Programin IPA për më tepër përfitues.

Ne përgatitëm këtë botim me objektivën që të prezantojmë një kuptim më të mirë të ndihmës të ofruar nga Bashkimi Europian. Botimi përmban përzgjedhje të projekteve, objektivat e tyre dhe rezultatet e parapara, të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e zhvillimit ekonomik, administrativ, arsimor dhe social të vendit.

Fushat e përfshira me këto projekte janë të ndryshme për nga veprimtaria, buxhetet dhe numri i ekspertëve, dhe mundësojnë një pasqyrë të mundësive të panumërta për ndihmë financiare të ofruar nga BE-ja. Këtu përfshihen projekte gjigante infrastrukturore, që vlejnë me dhjetra miliona euro, e deri në grante të vogla për OJQ-të, që funksionojnë në nivel lokal, furnizimi i pajisjes për policinë, reformat në gjyqësi, madje edhe regjistrimi i kafshëve. Me të gjitha këto, bashkimi Europian merr pjesë në mënyrë aktive dhe promovon mirëqenien e qytetarëve në pothuajse të gjitha aspektet e jetës së përditshme.

Projektet që do t'ju prezantohen në faqet në vijim janë ose të përfunduara, ose janë në progres, ose janë duke u planifikuar. Ato prezantojnë disa shembuj të "përvojës së mirë". Çdo projekt i prezantuar ose sferë, të cilës i jepet mbështetje financiare, është i përcjellur me hollësira teknike dhe rezultate, si dhe mendimet e përdoruesve që kanë vendosur të ndajnë përvojën e tyre me ne. Veç kësaj, çdo prezantim lidhet me një politikë të Bashkimit Europian. Nëse dëshironi të merrni informata më të hollësishme, ju lutemi referojuni listës së faqeve të internetit, të cilat mund t'i gjeni në fund të këtij botimi.

Shpresojmë që ky botim t'ju ndihmojë në përmirësimin e njohurive mbi çështjet specifike dhe të përgjithshme që kanë të bëjnë me BE-në, si dhe për mbështetjen e ofruar konkrete për qytetarët e këtij vendi të bukur, në rrugën e tyre drejt Bashkimit Europian.

Ervan Fuere



Një vështrim i shpejtë i ndihmës së BE

6
faqe



Bashkëpunimi pa kufij

Rindërtimi i rrugës tranzit M5 në Manastir,
nga veriu në lindje
Komuna e Manastirit
2007-2009

8
faqe



Shëndeti i konsumatorit vjen i pari

Siguria e ushqimit dhe kontrolli i kualitetit
Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Shëndetësisë
2007-2008

10
faqe



Modeli European i Policisë

Rindërtimi i stacioneve policore
Ministria e Punëve të Brendshme
2009-2011

12
faqe



Në kërkim të ajrit të pastër

Përmirësimi i Kualitetit të Ajrit
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
2006-2008

14
faqe



Infrastrukturë për jetë më të shëndetshme dhe të kualitetit të lartë

Rindërtimi i Sistemit për furnizim të ujit, shkarkim të ujërave të zeza
dhe drenim në qytezën e Lubashit, Komuna e Kavardarcit
2005-2007

16
faqe



Ndihma për individët e lumtur

Përfshirja sociale përmes zhvillimit të shkathtësive të reja,
PORAKA NOVA – Qendra për përmirësimin e kualitetit jetësor të
personave me paaftësi intelektuale dhe familjet e tyre, Strugë
2009-2010

18
faqe



Dogana moderne për shërbime kualitative

Përmirësimet e Kontrollit Kufitar
Administrata Doganore
2009-2011

20
faqe



Rritja e besimit në gjyqësi

Ndihmë për Funkionimin më efikas, më Efektiv
dhe modern të Gjykatës Administrative
Gjykata Administrative dhe Ministria e Drejtësisë
2010-2011

22
faqe



Inovacioni në afarizëm : kërcim përpara

Programi TAM,
Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
2006-2009

24
faqe



Tatimet në dobi të qytetarëve

Politika tatimore
Ministria e Financave dhe Drejtoria e të Ardhurave Publike
2010-2011

26
faqe



Burime të ngjashme onlajn

28
faqe

Një shikim i shpejtë i ndihmës së BE-së

Zgjerimi ka qenë në qendër të zhvillimit të Bashkimit Evropian gjatë disa dekadave. Agjenda aktuale e zgjerimit u përfshin vendet kandidatë – Turqia, Kroacia dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Islanda dhe Mali i Zi - si dhe vendet potenciale kandidatë – Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova¹, dhe Serbia.

Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë i është dhënë shpresa që të bëhet shtete anëtare e BE-së. Në rrugën drejt anëtarësimit, Bashkimi Evropian ofron mbështetje të vazhdueshme dhe ndihmë financiare, që të ndihmojë vendin me reformat e domosdoshme.

Që nga viti 1992 e deri në futjen në përdorim të Instrumentit për Ndhimë Para-anëtarësuese në vitin 2007 (thjesht e njohur si IPA), ndihma financiare e Bashkimit Evropian, e shpërndarë kryesisht përmes programeve PHARE dhe CARDS, arrinte shumën prej 800 milionë euro.



¹ Sipas Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244/99

Instrumenti për Ndhimë Para-anëtarësuese (IPA) hyri në fuqi në fillim të vitit 2007²² dhe duhet të ofrojë afro 11.5 miliardë euro për vendet candidate dhe potenciale candidate në periudhën 2007-2013. IPA fokusohet në nevoja. Kështu, prioritetet e IPA-s bazohen në vlerësime të qarta. Elemente kryesore janë Anëtarësimi/Partneritetet Europiane, të cilat BE-ja i ka themeluar me të gjitha vendet përfituese, dokumenti i strategjisë së Komisionit për Zgjerim, raportet vjetore mbi të gjitha vendet dhe strategjitë nacionale për integrim në BE dhe harmonizimi me Acquis-në. Ndhima e BE-së do t'u ndihmojë vendeve candidate që të implementojnë plotësisht legjislacionin e BE-së (*Acquis-në e Komunitetit*) deri në kohën kur do të bëhen Shtete Anëtare.

Për periudhën 2007 – 2013, ndihma e ofruar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, përmes IPA-s, përfshin pesë komponente: 1) Ndërtimi Institucional, 2) Bashkëpunimi Ndërkufitar, 3) Zhvillimi Rajonal, 4) Zhvillimi i Resurseve Njerëzore, 5) Zhvillimi Rural. Komisioni ka shënuar sumën e përgjithshme prej 622.4 milionë euro për periudhën 2007-2013. Vendi do të përfitojë gjithashtu edhe nga program i IPA-s multi-përfitues.

Ish republika Jugosllave e Maqedonisë: Pasqyrë treguese e zarfit të Instrumentit për Ndhimë Para-anëtarësuese për periudhën 2007-2013, sipas ndarjes në komponente*

Komponenti IPA	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
I (Ndhimë e tranzicionit dhe ndërtimi institucional)	41,641,613	41,122,001	39,328,499	36,317,068	28,803,410	28,207,479	27,941,228
II (Bashkëpunimi ndërkufitar)	4,158,387	4,077,999	4,371,501	5,067,526	5,124,876	5,183,373	5,243,041
III (Zhvillimi Rajonal)	7,400,000	12,300,000	20,800,000	29,400,000	39,300,000	42,300,000	51,800,000
IV (Zhvillimi i Resurseve Njerëzore)	3,200,000	6,000,000	7,100,000	8,400,000	8,800,000	10,380,000	11,200,000
V (Zhvillimi Rural)	2,100,000	6,700,000	10,200,000	12,500,000	16,000,000	19,000,000	21,028,000
Gjithsej	58,500,000	70,200,000	81,800,000	91,684,594	98,028,286	105,070,852	117,212,269

*Korniza treguese financiare shumë vjetore 2011-2013 COM (2009) 543 nga 14.10.2009

Financimi ndahet në pajtim me kornizën treguese financiare shumë-vjeçare, e cila përsëritet çdo tre vjet, që ka të bëjë me kornizën politike të zgjerimit. Kjo siguron informacion mbi synimet e Komisionit, në bazë të vendit dhe në bazë të komponentit.

Në bazë të kësaj, atëherë përgatiten dokumentet e planifikimit tregues shumë-vjetor për çdo vend (plus një nga programet e përfituesve të shumtë). Këto përmbajnë objektivat specifike të Komisionit dhe zgjedhjet për ndihmë para-anëtarësuese. Të njëjtat revidohen dhe azhurnohen çdo vjet.

Ndhimë e BE-së shënjestron drejtpërsëdrejti përfitimin e qytetarëve. Projektet që i përkrah BE-ja, janë të ingranuara të afrojnë vendet candidate dhe potenciale candidate më afër dhe në pajtim me standardet e BE-së. Ato janë gjithashtu të konstruara që në mënyrë progresive të lënë në dorëzim administratën e vendeve përfituese, me menaxhimin e decentralizuar të fondeve të BE-së. Menaxhimi i decentralizuar i fondeve të BE-së përfshin transferin e përgjegjësisë, nga Komisioni në Autoritetin Kontraktues të vendit përfitues. Autoriteti Kontraktues merr përgjegjësinë e shpalljes së tenderave dhe kontraktimit, si dhe për menaxhimin financiar dhe administrativ të projekteve. Krahas përkrahjes së ndjenjës së zotërimit në fazën para-anëtarësuese, kjo gjithashtu ndihmon për të përgatitur vendet për metodat e menaxhimit, të cilat do të duhet t'i pozicionojnë, ndërsa po i afrohen përfitimit nga fondet e BE-së si Shtete Anëtare.

Kjo broshurë ilustron disa nga projektet e financuara nga BE-ja në vend.

²² Rregullore e Këshillit (KE) nr 1085/2006, nga 17 korriku 2006, e cila themelon Instrumentin për Ndhimë Para-anëtarësuese

Bashkëpunimi pa kufij

Përvoja e Bashkimit European tregon se zhvillimi i rajoneve kufitare është faktor vendimtar për integrimin europian. Zhvillimi ekonomik, social dhe kulturor i këtyre rajoneve mund të përmirësohet nëse në thelbin e procesit të bashkëpunimit vendosen njerëz nga të dyja anët e kufijve. Për ata, përfitimi më i madh është njohuria më e mirë reciproke dhe mirëkuptimi me fqinjët e tyre. Me anë të komunikimit të rregullt, ata mund të këmbëjnë ide, përvojë, mund të zgjidhin probleme së bashku dhe të përkrahin njëri tjetrin. Projektet e përbashkëta mund t'u ndihmojnë atyre të përmirësojnë kushtet e jetesës dhe kualitetin e përgjithshëm të jetës – duke filluar nga lidhjet rrugore dhe zgjidhjet e problemeve të furnizimit me ujë dhe energji elektrike, e deri te evenimentet e përbashkëta kulturore dhe mbrojtja e thesareve natyrore dhe kulturore. Kjo do t'u mundësojë

atyre të promovojnë rajonin në të cilin jetojnë, gjë që do të sjellë përfitime të përbashkëta.

Në periudhën midis 2007 dhe 2013, do të implementohen pesë programe që do të përfshijnë bashkëpunimin bilateral të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë me Shqipërinë, Bullgarinë, Greqinë dhe Kosovën, si dhe bashkëpunimin multilateral përbrenda suazave të rajonit të Europës Juglindore. Është paraparë që Bashkimi European të kontribuojë në këto programe, në pesë vitet e para të periudhës programore, me rreth 23 milionë euro. Programi për bashkëpunim ndërkuftar me Kosovën, është pothuajse i miratuar nga Komisioni European dhe pritet që të fillojë në vitin 2011.

Programi me Shqipërinë është i pari i llojit të vet, që do të financohet nga Instrumenti për Ndihmë Para-

Emri i projektit:
Rindërtimi i rrugës tranzitore
M5 në Manastir, nga veriu në
lindje.

Sektori:
Bashkëpunimi ndërkuftar

Burimi i financimit:
CARDS

Vlera:
738,000 euro

Periudha:
2007-2009

Përfituesi:
Komuna e Manastirit

**Partner në
Republikën e Greqisë:**
Komuna e Florinës



anëtarësuese (IPA), kurse programet e tjera janë vazhdim i përkrahjes të siguruar përmes Programit CARDS.

Dobitë

Vitin e kaluar, qytetarët e komunës së Manastirit ishin dëshmitarë të përfitimëve të ndihmës së ofruar nga Bashkimi Europian. Ata më në fund fituan një rrugë moderne tranzite që kalon përmes qytetit të tyre dhe në mungesë të linjës hekurudhore, njëkohësisht është lidhja e vetme me Greqinë fqinje. Me ndihmën e Bashkimit Europian prej mbi 700,000 euro, edhe pavarësisht nga disa çështje të paparapara, Komuna e Manastirit arriti të respektojë afatet dhe të rindërtojë rrugën M5, me gjithë infrastrukturën nëntokësore, dhe të sigurojë sigurinë maksimale për këmbësorët në njërën nga rrugët më të frekuentuara të qytetit. Veç kësaj,

ata patën mundësinë të përforcojnë bashkëpunimin me Komunën greke të Florinës, për këmbim më të madh të njerëzve dhe mallërave, por gjithashtu edhe për zhvillimin e përgjithshëm të rajonit.

Gjithashtu, ekzistojnë edhe shumë shembuj të tjerë pozitivë të bashkëpunimit ndërkuftar. Mbi tetë mijë qytetarë të Bogdancit dhe rrethinës, nuk duhet më të brengosen për ujin e pastër dhe të pijshëm. Linja e re e furnizimit të ujit, ku gypat e asbestit u zëvendësuan me gypa polietileni, zvogëluan rrezikun nga sëmundjet kancerogjene dhe në masë të madhe zvogëluan rrjedhjen e ujit, kurse kursimi i përgjithshëm i kostos rrjedhëse pritet të jetë rreth 43%. Krahas kësaj, nëse ka nevojë, edhe Komuna greke Kiros mund të furnizohet me ujë të pastër dhe të pijshëm. Materiali reklamues për rajonin e Prespës,

lokalitetet historike dhe kulturore, shërbimet turistike, si dhe mundësitë për vendosje në objekte të themelura nga autoritetet lokale turistike në gjashtë fshatra, në pajtim me standardet e BE-së, promovuan Prespën si një destinacion atraktiv turistik.

Promocioni tjetër turistik është në Lesnovo dhe financohet nga programi CARDS, së bashku me Bullgarinë fqinje. Përmes infrastrukturës së përmirësuar në fshat dhe me materialet reklamuese mbi manastirin Shën Gavril Lesnovski, rajoni tani është më i afërt dhe më atraktiv për vizitorët.

Qytetarët e fshatrave Duraçka Reka dhe Drenak në Komunën e Kriva Pallankës kanë gjithashtu arsye për të qënë të kënaqur, pasi që ata u lidhën me rrugë të asfaltuar, e cila ka hapur mundësitë për zhvillim ekonomik dhe turizëm në bashkëpunim me Komunën Dupnica të Bullgarisë fqinje.

REZULTATET:

Komuna e Manastirit

- Reduktim në vëllimin e trafikut në rrugën që lidh dy hyrjet në Manastir, e cila njëkohësisht është rruga e vetme tranzit që shpie drejt Greqisë
- Rindërtimi i infrastrukturës për ujin e pijshëm

“Realizimi i këtij projekti na mundësoi, jo vetëm të përmirësojmë kualitetin e jetës në qytetin tonë por gjithashtu lejoi një përkrahje reciproke me Greqinë fqinje. Tani, pasi që u ndërtua rruga, jemi lidhur më mirë me disa nga komunat në anën tjetër të kufirit dhe kjo mundëson këmbimin më të lehtë të mallërave dhe bashkëpunim të përmirësuar midis njerëzve. Në fakt, me ndihmën e BE-së, ne përforcuam bashkëpunimin e mirë me komunat e Greqisë, në të gjitha nivelet. Ajo që është më me rëndësi është se ky bashkëpunim përkrah edhe zhvillimin e rajonit, gjë që është në interes të qytetarëve në të dyja anët e kufirit”

VLADIMIR TALESKI,
Kryetari i Komunës së Manastirit



QËNDRIM NGA BE-ja:

Bashkëpunimi ndërkuftar si pjesë e politikës rajonale të BE-së

Bashkëpunimi ndërkuftar është pjesë përbërëse e politikës rajonale të Bashkimit Europian, që ka për qëllim të përmirësojë kohezionin ekonomik dhe social, dhe të zvogëlojë dallimet në zhvillimin e rajoneve të ndryshme të Europës. Për këtë arsye, fondet strukturore dhe para-anëtarësuese të Bashkimit Europian, ndihmojnë bashkëpunimin ndërkuftar, qoftë në territorin e vet, qoftë midis vendeve candidate për anëtarësim. Idea për ndihmën para-anëtarësuese është të zvogëlojë ndikimin negativ të kufijve, në zhvillimin ekonomik dhe social të zonave kufitare. Prandaj përfutjesit kryesorë të projekteve janë njerëz që jetojnë në këto zona.

www.ec.europa.eu/dgs/regional_policy

Shëndeti i konsumatorit vjen i pari

Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit të tyre është shqetësimi kryesor i sigurisë së ushqimit në të gjitha fazat e prodhimit dhe tregtisë. Konsumatorët duan ushqim të sigurtë, por gjithashtu duan të dijnë se çfarë ushqimi konsumojnë.

Në sajë të ndihmës së Programit CARDS 2006 të Bashkimit Europian, në formë të pajisjes së sofistikuara me vlerë rreth 88,000 euro, tani është e mundur të bëhet testimi i kualitetit të produkteve dhe rezultatet të merren në terren, në afat 15 minutësh. Në vend të pritjeve të gjata të rezultateve laboratorike, inspektorët ushqimorë mund të marrin informata për afat shumë të shkurtër kohor nëse, për shembull, niveli i pesticideve në frutat dhe perimet e tyre është në suaza të kufijve të lejueshëm. Ata gjithashtu mund të masin tem-

peraturën e tyre, lagështinë dhe thartësinë e produkteve, kualitetin e qumështit dhe llojeve të ndryshme të mishit...

Me ndihmën e Bashkimit Europian, vendi ka ecur përpara në aspektin e sigurimit të kualitetit, në pajtim me standardet europiane. Analizat e ushqimit nuk bëhen vetëm nëpër laboratore, por gjithashtu edhe në terren. Shëndeti dhe interesat e konsumatorëve janë qëllimet kryesore të çështjes të sigurisë së ushqimit, duke përdorur qasjen e integruar “nga ferma në tryezë”, e cila pëfshin të gjithë sektorët në zinxhir. Parimet e politikës Europiane mbi sigurinë e ushqimit janë të përfshira në “Dokumentin e Bardhë mbi Sigurinë e Ushqimit”, i cili ka paraparë prezantimin e 80 masave të reja legjislative për të ushqyerit e kafshëve, shëndetin e

Emri i projektit:
Siguria e ushqimit dhe kontrolli i kualitetit

Sektori:
Siguria e ushqimit, veterinaria dhe politika fitosanitare

Burimi i financimit:
CARDS

Vlera:
464,000 euro

Periudha:
2007-2008

Përfutues:
Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Shëndetit



tyre, higjienën, aditivet, ëmbëlsuesit, ndotësit dhe fundërresat, aromatizuesit, përbërësit e modifikuar gjenetikisht në ushqim, si dhe radiacionin dhe paketimin.

Vendi ka përparuar shumë në këtë fushë, por më tepër duhet bërë, për të harmonizuar legjislacionin nacional me atë të BE-së. Në katër vitet e fundit, Bashkimi Europian mbështeti themelimin e sistemit efikas për sigurinë e ushqimit, përmes projekteve me vlerë prej 620,000 euro. Veç kësaj, për të punësuarit e Drejtorisë Ushqimore në Ministrinë e Shëndetësisë, midis korrikut të vitit 2008 dhe gushtit të vitit 2009 u organizuan mbi se 30 misione eksperte dhe udhëtime mësimore në

vendet e Bashkimit Europian.

Identifikimi dhe regjistrimi i bagëtive sipas standardeve europiane

Bashkimi Europian ka strategji gjithëpërfshirëse për sigurinë e ushqimit, e cila, përveç ushqimit, përfshin shëndetin e bagëtive. Në vitin 2002, Agjencia Europiane për Rindërtim inicioi një program për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, me vlerë prej 3,500,000 euro. Qëllimi ishte të themelohet një sistem që identifikon bagëtinë, në pajtim me rregullativat europiane, në mënyrë që të përmirësojnë monitorimin e shëndetit të kafshëve. Kjo nënkupton edhe

reagimin më efikas të veterinarëve në raste të sëmundjeve dhe kufizimin e ndërlikimeve dhe konsekuencave negative ekonomike për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve.

Ky projekt, i cili u ndërmor në tre faza dhe u përfundua në vitin 2009, siguroi pajisje hardverike dhe softverike për bazën qendrore të të dhënave, themeloi një sistem për identifikimin dhe regjistrimin e bagëtisë, si dhe regjistrimin e deleve dhe dhive. Identifikimi mundëson monitorimin e bagëtive dhe prodhimeve të mishit, gjatë të gjitha fazave të prodhimit, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes më të mirë nga sëmundjet dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

REZULTATET:

- Kontrolli i shpejtë i sigurisë dhe kualitetit të ushqimit
- Harmonizimi i legjislacionit mbi ushqimin dhe hajet e kafshëve, me legjislacionin e BE-së
- Vetëdija e ngritur midis palëve përgjegjëse dhe hartuesve të ligjit mbi sigurinë e ushqimit
- Personeli i trajnuar në institucionet kompetente që kontrollojnë sigurinë e ushqimit
- Harmonizimi dhe koordinimi i aktiviteteve të Departamentit Ushqimor dhe Departamentit Veterinarik
- Themelimi i një sistemi për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve

“Ne kemi arritur progres në fushën e legjislacionit, gjë që është një nga elementet themelore të sistemit për kualitet të ushqimit, kurse punëtoritë e realizuara përbrenda kornizës së projektit, ndihmuan në këmbimin e njohurive dhe përvojave midis të gjithë atyre të involvuar në sistemin ushqimor në vend dhe që kanë të bëjnë me politikën e ushqimit dhe menaxhimin e sigurisë së ushqimit në nivel të BE-së. Projekti kontribuoi në përforcimin dhe kapacitetin institucional të sistemit ushqimor, kurse përfitimi nga përgatitja e “Portalit mbi Sigurinë e Ushqimit” – faqe interneti që ofron informata të përgjithshme mbi sistemin e sigurisë së ushqimit – është i pamasë.”



D-r. MARIINA POPOVSKA-DOMAZETOVA,
Drejtoreshë në Drejtorinë e Ushqimit –
Ministria e Shëndetësisë

QËNDRIM NGA BE-ja:

Bashkimi Europian ka një strategji gjithëpërfshirëse për sigurinë e ushqimit, e cila përfshin ushqimin e kafshëve, si dhe shëndetin e bagëtive. Objektiva kryesore e politikës të Komisionit Europian për siguri të ushqimit, është të sigurojë nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe interesave të konsumatorëve lidhur me sigurinë e ushqimit. Para hyrjes në BE, vendet kandidate duhet të miratojnë rregullat e përbashkëta dhe standardet e ligjeve europiane mbi sigurinë e ushqimit. Komisioni Europian nuk bën asnjë kompromis në këtë fushë, nuk lejon “periudha tranzicioni” dhe nuk pranon asnjë dobësim të standardeve.

http://ec.europa.eu/dgs/health_consumer

Modeli European i Policisë

Të drejtat e njeriut, institucionet demokratike dhe sundimi i ligjit janë tre vlera të përbashkëta themelore për sigurimin e paqes dhe zhvillimit të suksesshëm të Bashkimit Europian. Respektimi i këtyre vlerave, reformat e domosdoshme politike, ekonomike dhe institucionale shpiejnë drejt rezultateve në terren dhe shërbejnë si bazë për zgjerimin e Bashkimit Europian.

Respektimi i këtyre vlerave do të jetë i vështirë pa forcat e reformuara policore, pa zyrtarët e motivuar policorë dhe pa kushtet e duhura të punës. Në procesin e reformave, vendet nuk janë të lëna vetëm dhe BE-ja qëndron në anën e tyre me përkrahje politike, ndihmë teknike, si dhe me ndihmë të rëndësishme financiare për projektet që do të përmirësojnë jetën e qytetarëve.

Prandaj, Bashkimi European përkrah reformën e policisë në vend, në mënyrë që të arrijë nivel më të lartë të respektimit të të drejtave të njeriut dhe të zbatojë standardet minimale që kanë të bëjnë me kushtet fizike të stacioneve policore, ku përfshihet rindërtimi i godinave dhe objekteve të tjera.

Godina moderne për punë efikase

Me një shumë mbi 1,300,000 euro, një pjesë e të cilës janë nga programi CARDS dhe pjesa tjetër nga programi IPA, Bashkimi European ndihmon rindërtimin e dhjetë stacioneve policore në vend. Qëllimi i këtyre rindërtimeve është të arrihet nivel i harmonizimit me standardet europiane në fushën e punës policore, për sa i përket trajtimit të individëve të ftuar në gjyq, të arrestuar dhe të parabur-

Emri i projektit:
Rinovimi i stacioneve policore

Sektori:
Menaxhimi Policor dhe Kufitar

Burimi i financimit:
CARDS - IPA

Vlera:
1,373,000 euro

Periudha:
2009-2011

Përfitues:
Ministria e Punëve të Brendshme



gosur, si dhe në lidhje me krijimin e kushteve të duhura për të punësuarit në stacionet policore.

Të punësuarit në stacionin policor në Kisella Voda, për të cilët u ndërtua godinë moderne, tani më janë duke i gëzuar kushtet normale të punës. BE-ja ndau rreth 500,000 euro nga programi CARDS 2006, për rindërtimin e plotë të stacionit.

Kohët e fundit, nga kushtet e përmirësuara të punës përfitojnë edhe të punësuarit në Stacionin Policor të Tetovës, rindërtimi i të cilit kushtoi rreth 400,000 euro, shumë kjo e cila u mundësua nga programi IPA 2007. Kushtet e përmirësuara të punës do të rrisin efikasitetin e policisë të një stacioni policor që shërben 190 mijë qytetarë në rajonin e Tetovës, por i cili nuk ka pasur pothuajse asnjë

investim në instalimet hidrosanitare apo në përmirësimin e kushteve të punës për mbi se 30 vjet.

Mirëpo projekti nuk mbaron këtu. Ka filluar edhe rindërtimi i tetë stacioneve të tjera policore dhe atë në Shkup, rindërtimi i stacioneve policore Qendër, Gazi Babë, Karposh dhe Bit Pazar, si dhe në Prilep, Gostivar, Gjevgjeli dhe Shtip. Për rindërtimin e këtyre stacioneve janë siguruar mbi se 400,000 euro edhe nga programi IPA 2007.

Tani mbetet që zyrtarët e policisë të japin mundin e tyre për menaxhimin e sfidave të sigurisë, në interes të paqes, sigurisë dhe qetësisë të qytetarëve. Kjo është një detyrë dhe prioritet, të cilit ata do t'i përkushtojnë kohë, përpjekje dhe energji, dhe për të cilën nuk do të kursejnë vetveten, pasi që

qytetarët me nevojat dhe kërkesat e sigurisë së tyre duhet të jenë në krye të agjendës së tyre të punës.



REZULTATET:

- Funksionim më i mirë, më efikas dhe më i efektshëm i shërbimeve policore
- Numër më i vogël i ankesave nga qytetarët, organizatat joqeveritare dhe komuniteti ndërkombëtar, lidhur me godinat policore
- Nivel më i lartë i standardeve ndërkombëtare të kapaciteteve policore në të gjitha aspektet
- Motivim më i lartë i personelit policor

“Së bashku me partnerët tanë të Delegacionit të BE-së, ne identifikua stacionet policore që kishin nevojë për rindërtim urgjent dhe filluam punën në fundin e vitit të kaluar. Shpresojmë që kontributi ynë në përmirësimin e kushteve të punës do të shtojë efikasitetin në radhët e policisë, do të përmirësojë shërbimet e qytetarëve dhe implementimin praktik të rregullave në Marrëveshjen Kornizë.”



GORDANA JANKULLOVSKAJA,
Ministreshë e Punëve të Brendshme, me rastin
e rindërtimit të stacionit policor në Tetovë (22 qershor 2009)

QËNDRIM NGA BE-ja:

Reformat e policisë dhe gjyqësisë

Implementimi i sundimit të ligjit, sidomos përmes reformave policore dhe gjyqësore, është prioritet. Policia dhe gjyqësia efikase janë dy elementet kryesore dhe parakushtet e sundimit të ligjit dhe demokracisë. Modernizimi i kapaciteteve dhe përkrahja e implementimit të standardeve ligjore të BE-së, të cilat përforcojnë menaxhimin e resurseve njerëzore, janë qëllimet kryesore të ndihmës së Bashkimit Europian. Pajisjet e duhura përgatisin policinë për luftë më efikase kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për implementim më efikas të politikës së migracionit, si dhe për kontrollin e përmirësuar kufitar.

http://ec.europa.eu/justice_home

Në kërkim të ajrit të pastër

Të gjithë ne, shijojmë marrjen e ajrit të pastër dhe të freskët që stimulon ndjenjat. Mirëpo sot, ndotja e ajrit është problem që nuk mund të injorohet. Është diçka që mund ta ndjeni që nga çasti që largoheni nga shtëpia juaj dhe ballafaqoheni me smogun dhe tymin që del nga tubet e shkarkimit të makinave, të cilat të përkujtojnë se thithja e ajrit të pastër është një kujtim i largët. Prodhimtaria industriale dhe energjetike, karburantët e ngurtë dhe rritja dramatike e trafikut rrugor, ndikojnë në ndotjen e ajrit nëpër qytete, duke shkaktuar probleme serioze shëndetësore. Ekspertët thonë se ajri i ndotur është shkaktari kryesor i sëmundjeve të mushkërive siç është astma. Sot, astma prek dyfish më tepër njerëz në krahasim me 20 vjet më parë.

Në këto kushte të kërcënimit të rëndë të shëndetit dhe kualitetit tonë të jetës, matja dhe kuptimi i ndotjes së ajrit mundëson bazë të shëndoshë shkencore për menaxhimin dhe kontrollimin e kësaj ndotjeje në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, është me rëndësi të vlerësohen emetimet e substancave ndotëse, në mënyrë që të përkufizohet niveli dhe distribuimi i tyre në ajër, dhe të bëhet matja e koncentrimit të tyre në terren.

Projekti i parë Tuining në Ballkan

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, me ndihmën financiare të Bashkimit Europian, implementoi projektin "Përmirësimi i Kualitetit të Ajrit"; projekti i parë tuining në fushën e mjedisit në vend dhe në Ballkan. Së bashku me Finlandën, si partner

Emri i projektit:
Përmirësimi i kualitetit të ajrit

Sektori:
Mbrojtja e Mjedisit

Burimi i financimit:
CARDS

Vlera:
635,000 euro

Periudha:
2006-2008

Përfitues:
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor

Partner Tuining:
Instituti Meteorologjik Finlandez



tuining, dhe Austrinë, partner më i ri, Ministria përdori dhe shpërndau në mënyrë efektive 635,000 euro të programit CARDS, midis vitit 2006 dhe 2008.

Legjislacioni implementues u hartua përbrenda kornizës së harmonizimit të mëtejshme me legjislacionin e BE-së mbi kualitetin e ajrit; u trajnuan 50 njerëz, si dhe u përgatitën materiale dhe doracakë për trajnim. Në të njëjtën kohë, u bënë përmirësime të kapaciteteve institucionale dhe mjeteve për evidentimin e emetimeve, si dhe të metodologjisë për vlerësim preliminar, të funksionimit të laboratorëve të kalibrimit dhe funksionimit të laboratorëve të lëvizshëm për monitorimin e emeti-

meve. Veç kësaj, u përfundua plani për përmirësimin e menaxhimit të të dhënave, personelit iu mundësua trajnim i duhur për matjen e emetimeve dhe u themelua modelimi i shpërndarjes.

Megjithatë, në mënyrë që të ndërmerren aktivitetet e përmirësimit të kualitetit të ajrit, paraprakisht nevojitet monitorim. Kjo është mundësuar me anë të tetë stacioneve për monitorimin e kualitetit të ajrit në Manastir dhe Veles (nga dy në secilin qytet), Tetovë, Lazaropole, Kavadarci dhe stacioni për monitorimin e ndotjes nga komunikacioni, në zyrën e Rektorit të Universitetit "Kirili dhe Metodi" në Shkup. Stacionet u themeluan me ndihmën financiare në vlerë

prej 1.1 milionë euro, nga program CARDS i BE-së, në vitin 2004.

Këto stacione dhe stacionet e fiksuar të monitorimit me vlerë prej 350 mijë euro, mundësojnë realizimin e vlerësimeve preliminare të kualitetit të ajrit dhe lejojnë që vendi të ndahet në dy zona, në bazë të kualitetit të ajrit. Mirëpo, kjo është thjesht një pikënisje për përgatitjen e planeve dhe programeve për përmirësimin e kualitetit të ajrit.

"Qendra Informative e Mjedisit në Maqedoni", në suaza të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, grumbullon, sistemon, analizon, përpunon dhe administron të dhënat mbi mjedisin, përfshirë edhe kualitetin e ajrit.

REZULTATE:

- Përgatitja e udhëzuesve dhe implementimi i legjislacionit
- Inventari i emetimeve dhe përmirësimi i bazës së të dhënave
- Vlerësimi preliminar i kualitetit të ajrit
- Matjet e kualitetit të ajrit dhe puna laboratorike. Përforsimi i kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor për mirëmbajtjen, servisimin dhe kalibrimin e instrumenteve për monitorimin e kualitetit të ajrit, si dhe matja e emetimeve në ajër
- Modeli i shpërndarjes

"Të gjitha projektet e implementuara në mënyrë direkte ose indirekte përmirësojnë segmente të ndryshme të sistemit për monitorimin e kualitetit të ajrit, si dhe mirëmbajtjen e tij. Legjislacioni i përgatitur, përshkruan obligimet e autoriteteve të nivelit qendror dhe lokal për monitorimin dhe raportimin mbi kualitetin e ajrit, si dhe për të përgatitur plane dhe programe për përmirësimin dhe mbrojtjen e kualitetit të ajrit. Dhe së fundi, të gjitha këto projekte gjithashtu kanë ndikim serioz në ngritjen e vetëdijes politike dhe publike për rëndësinë e sistemit të monitorimit të kualitetit të ajrit në vendin tonë."



SVETLANA GJORGJEVA,
Shefe e Departamentit, 'Qendra Informative e Maqedonisë për Mjedisin',
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor

QËNDRIM NGA BE-ja:

Lufta kundër ndotësve

Përveç luftës kundër fenomenit të serrave, i cili po ndryshon klimën, qëllimi kryesor i legjislacionit për mjedisin është të përmirësojë kualitetin e ajrit, ndotja e të cilit i shkakton pasoja shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Politika europiane është e orientuar drejt llojeve dhe burimeve të ndryshme të ndotjes. Si rezultat i legjislacionit europian, është avancuar në luftën kundër ndotësve siç janë sulfur dioksidi, nitrogjen oksidet dhe dioksid karboni, mirëpo ajri i ndotur vazhdon të shkaktojë problem. Prandaj, në vitin 2005, Komisioni Europian propozoi strategji për të reduktuar numrin e vdekjeve të shkaktuara nga ndotja e ajrit për 40% (të nivelit në vitin 2000) deri në vitin 2020.

<https://ec.europa.eu/environment/air>

Infrastrukturë për jetë më të shëndetshme dhe të kualitetit të lartë

Rreth dhjetë mijë qytetarë të Lubashit, një nga qytezat më të mëdha të Komunës së Kavadarçit, mund të jenë të kënaqur. Ata fituan një rrjet të ri të furnizimit të ujit me ujë të pastër dhe të pjishëm të kualitetit të mirë.

Njëkohësisht, në qytezën e tyre u ndërtua sistemi i ujërave të zeza, kështu që tani nuk ballafaqohen më me vërshimet e shpeshta të shtëpive dhe bodrumeve, pas shirave të rrebeshta. Pas 40 vite përdorimi, u zëvendësuan gypat e sistemit të furnizimit të ujit, të ndërtuara nga asbesti-çimentoja, material i dëmshëm për shëndetin e njeriut. Gypat e gjysmëshkatëruara, gjithashtu janë vjetëruar nga rrjedhjet e shpeshta të ujit, të cilat kanë shkaktuar humbje të mëdha të ujit. Defektet e rrjetit të vjetër të ujërave të zeza ishin të zakonshme dhe shkaktorin derdhjen e ujërave të zeza në qytet. Të gjitha këto probleme krijuan një

stimul të mjaftueshëm, që autoritetet lokale të përgatisin projektin e Rindërtimit të Sistemit të Furnizimit të Ujit, Kanalizimit dhe Drenimit në qytezën Lubash dhe të sigurojnë ndihmën e Bashkimit Europian, me vlerë prej 420,000 euro. Krahas ndihmës së Bashkimit Europian, Komuna ndihmoi me rreth 80,000 euro, duke financuar në këtë mënyrë zëvendësimin e gypave të asbestit në rrjetin e ujit – 3,446 metra – me gypa PVC, rindërtimin e 3,331 metrave të rrjetit të ujërave të zeza, ndërtimin e 1356 metra drenimi dhe rindërtimin e sipërfaqeve rrugore. Së fundi, dy rrjetet u lidhën në sistemin e grumbullimit të Lumit Lluda Mara. Përfitimet ndjehen jo vetëm nga banorët e Lubashit, por gjithashtu edhe nga qytetarët e Komunës së Kavadarçit. Ata kanë kushte më të mira të jetesës dhe mbrojtje më të madhe të mjedisit.

Emri i projektit:
Rindërtimi i Sistemit për furnizimin e ujit, shkarkimit të ujërave të zeza dhe drenimit në qytezën e Lubashit, Komuna e Kavadarçit

Sektori:
Vetëqeverisja Lokale

Burimi i financimit:
CARDS

Vlera:
500,000 euro

Periudha:
2005-2007

Përfitues:
Komuna e Kavadarçit



Mbështetja për autoritetet lokale

Projekti në Kavadarci është një nga qindra projektet e implementuara në vend, në suaza të kornizës të ndihmës së BE-së, për procesin e decentralizimit. Këto janë projekte të vogla, deri në 500,000 euro, të cilat ndahen për komunat që kanë dorëzuar aplikacione në shpalljen publike.



Në dhjetë vjetët e fundit, Bashkimi European, përmes programeve CARDS dhe IPA, ka siguruar mbi se 60,000,000 euro për projektet që përfshijnë decentralizimin fiskal, infrastrukturën komunale, bashkëpunimin ndërkuftar komunal, zhvillimin rajonal ekonomik dhe trajnimin e të punësuarve në komuna dhe në Minis-

trinë e Vetqeverisjes Lokale.

I tërë procesi është i fokusuar në mirëqenien e qytetarëve dhe lehtësimin e jetës së tyre, por kjo gjithashtu përfshin edhe mbështetjen për ndërtimin e kapaciteteve nëpër komuna. Qëllimi i mbështetjes europiane është të ndihmojë qeverisjen lokale të përgatitet për dorëzimin më të lehtë të përgjegjësiqe që janë

rrjedhojë e decentralizimit, për të ndihmuar autoritetet lokale të përmirësojnë aftësitë menaxhuese, për të shtuar transparencën dhe të përmirësojnë konkurrencën dhe shkathtësinë për të planifikuar më mirë detyrat prioritare. Projekti në Kavadarci, si dhe ndërtimi i klinikës në Komunën e Vrutokut, rrugët lokale në Dollneni, Rosoman dhe Konopishte, si dhe rrjetet e ujërave të zeza në 12 zona rurale në Manastir, Ohër, Kumanovë, Strumicë, Shtip dhe Shkup, tregojnë se këto qëllime mund të arrihen. Komunat konfirmuan se decentralizimi mund të jetë plotësisht funksional me përkushtim të plotë dhe përpjekje të përbashkëta. Vetëm në këtë mënyrë, ata do të kenë qytetarë të kënaqur.

REZULTATE:

- Furnizimi i përmirësuar i ujit
- Sigurimi i ujit të pijshëm të shëndoshë dhe të kualitetit të mirë
- Eliminimi i humbjes së ujit
- U çrrënjës problemet e derdhjes së ujërave të zeza në zonat publike urbane të qytetit. Rritje e nivelit të mbrojtjes së mjedisit me anë të ndarjes së rrjetit të ujit të shirave nga rrjeti i ujërave të zeza

“Unë jetoj në Lubash që nga viti 1986. Këtu kemi pasur probleme të vazhdueshme me furnizimin e ujit. Unë jetoj në katin e katërt dhe uji shpesh na ndërpritej. Ishte e pamundur të bëjmë higjienën elementare dhe punët shtëpiake. Mbushnim shishe me ujë që të mund t'i lajmë duart ose kova me ujë që të lëshojmë ujin në toalet. Të gjitha këto probleme, duke përfshirë edhe vërshimin e shpeshtë të rrugëve, u zhdukën pas rindërtimit të sistemit për furnizim të ujit dhe për drenim. Tani mund të mburremi se standardi ynë i jetesës është përmirësuar dhe i jemi mirënjohës Bashkimit European dhe komunës sonë që na kanë ndihmuar.”



LJUBICA LEVOVA,
Qytetare e Kavadarcit

QËNDRIM NGA BE-ja: Politika rajonale

Misioni i Drejtorisë Gjenerale për Politikë Rajonale është të përforcojë kohezionin ekonomik, social dhe territorial duke zvogëluar pabarazitë në nivelet e zhvillimit të rajoneve dhe vendeve të Bashkimit European. Në këtë mënyrë, politika kontribuon në mënyrë pozitive në ekonominë e përgjithshme të BE-së. Me kofinancimin e projekteve infrastrukturore, zhvillimin e shoqërisë informative, përkrahjen e investimeve në njerëz dhe inkurajimin e bashkëpunimit ndërkuftar, rajonet më pak të zhvilluara dhe ato që kanë probleme strukturore pranojnë ndihmë për të përmirësuar konkurrencën dhe njëkohësisht për të arritur shkallë më të shpejtë të zhvillimit të vazhdueshëm ekonomik.

http://ec.europa.eu/dgs/regional_policy

Përkrahja për individët e lumtur

Dhuroni dashurinë dhe kujdesin tuaj njerëzve me paaftësi intelektuale. Ata dijnë të çmojnë dashurinë dhe dijnë ta kthejnë atë. Të jeni të sigurtë...Ky është mesazhi me të cilin Qendra për Përmirësim të Kualitetit të Jetës për Personat me Paaftësi Intelektuale dhe Familjet e tyre – PORAKA NOVA nga Struga, organizon punëtori për familjet e personave me paaftësi intelektuale. Synimi është të përmirësohet kualiteti i jetës të këtyre individëve dhe familjeve të tyre dhe njëkohësisht t'u ndihmohet familjeve të tyre të kuptojnë nevojat e fëmijëve të tyre, duke filluar nga fakti se paaftësia intelektuale është gjendje dhe jo sëmundje e pashërueshme, e deri te zhvillimi dhe avancimi i aftësive ekzistuese te këta individë. Prandaj, trajnimi i familjeve është tejet i rëndësishëm, ku ata mësojnë mënyrën si të kujdesen për personat me paaftësi intelektuale, si

t'i trajtojnë ata, si dhe t'i përfshijnë në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Ata duhet të pranojnë faktin që fëmija i tyre është me të meta dhe në vend se ta fshehin nga "bota e jashtme", t'i mundësojnë të vendosë për vetvete. Krahas takimeve me familjet dhe pronarët e ndërmarrjeve që punësojnë persona me paaftësi intelektuale, PORAKA NOVA gjithashtu angazhohet për hapjen e qendrës rekreative me persona të trajnuar, të cilët do të përgatisin programe të bazuara në parimin e përfshirjes. Me ndihmën e tyre, vizitorët, qofshin ata fëmijë, adoleshentë ose të rritur, do të kenë mundësinë të bëjnë punime të dorës, piktura, të vallëzojnë, këndojnë, të kremtojnë ditëlindjet, të marrin pjesë në evenimente, të shetisin në natyrë, të shkojnë në kinema, teatër, muze, ekspozita... Ata do të mësojnë të përgatisin, të punojnë në oborr, të mësojnë gjuhë, të përdorin

Emri i projektit:

Na lejoni të zhvillojmë shkathtësi të reja. Përfshirja sociale përmes zhvillimit të shkathtësive të reja

Sektori:

Të Drejtat e Njeriut

Burimi i financimit:

Instrumenti European për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut

Vlera:

40,000 eturo

Periudha:

2009-2010

Përfutjes:

PORAKA-NOVA - Qendra për përmirësimin e kualitetit jetësor të personave me paaftësi intelektuale dhe familjet e tyre, Strugë



kompjuterët e madje edhe të organizojnë teatër kukullash! Në parim, ata do të mësojnë se me ndihmën e duhur, mund të jenë të arsimuar, të përfshihen në shoqëri dhe të jenë të lumtur duke pasur një rol të dobishëm në shoqëri. Deri në dhjetor 2010, si rezultat i projektit me vlerë prej 55,000 euro, nga të cilat 40,000 euro ishin ndihmë e BE-së, Qendra planifikon përgatitjen e bazës së të dhënave për personat me paaftësi intelektuale në Komunën e Strugës, në bazë të parametrave të ndryshëm – lloji i paaftësisë, gjinia, mosha, adresa, statusi social, etj. Baza e të dhënave do të përdoret për të hartuar aktivitete që do të fokusohen në nevojat e personave me paftësi intelektuale.

Projektet për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut

Bashkimi European, nga 54 projekte të propozuara, përkrahu edhe dhjetë projekte që synojnë përfundimin e rolit të shoqërisë civile dhe përmirësimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, me gjithsej 603,000 euro. Qendra për Zhvillim të Vazhdueshëm PORTA, nga Strumica mori 70,000 euro për projektin “Ndaloni Diskriminimin”; Qendrës të Iniciativës Qytetare iu ndanë 59,000 euro për projektin “Mekanizmi për Eliminimin e Diskriminimeve në Komunitet”, kurse 38,000 euro shkuan për Koalicionin “Të gjithë për Gjykimet të Lira”, nga Shkupi, për projektin “Projekti i Përkrahjes së të Drejtave të Njeriut”. Qendra e Maqedonisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar mori ndihmë prej 64,000 euro për “Analizën e Implementimit të Marrëveshjes së Ohrit”. Shoqata qytetare MOST (URA) mori 49,000 euro për “Votues për herë

të parë”; Fondacioni Metamorfozis mori 65,000 euro për “Modeli për Komunikim Eftikas midis Komisioneve për Marrëdhënie Ndëretnike dhe Qytetarëve”, kurse 47,000 euro iu dhanë Qendrës për Hulumtim dhe Bërje të Politikës nga Shkupi, për projektin “Zëri im, Vendimi im – Ndaloni votimin grupor në emër të të tjerëve”. 60,000 euro përkrahën Shoqatën ndërkombetale të Personave me të meta fizike – Manastir, Resnjë dhe Demir Hisar për projektin “Promovimi dhe Ratifikimi i Konventës të KB-së mbi të Drejtat e Personave me të meta”. Shoqata e qytetarëve REAKTOR mori 49,000 euro për projektin “Femrat në Ekonominë e Maqedonisë”, kurse Lobit të Femrave dhe Aktivitetit kundër Dhunës dhe Trafikimit të Femrave iu ndanë 59,000 euro për “Përfundimin e Kapaciteteve për Menaxhimin e Trafikimit nga Perspektiva e të Drejtave të Njeriut.”

REZULTATET E PARAPARA:

- Përmirësimi i shkathtësive të personave me paftësi intelektuale
- Ngritja e vetëdijes midis prindërve dhe familjeve të personave me paftësi intelektuale
- Organizim i aktiviteteve rekreative për personat me paftësi intelektuale
- Më tepër pushime dhe kohë të lirë për familjet, si dhe mundësi punësimi për anëtarët e familjes
- Krijimi i bazës së të dhënave mbi personat me paftësi intelektuale në Strugë

“Luftimi i mospërfshirjes sociale nuk është punë e lehtë. Mirëpo, të shohësh buzëqeshjet në fytyrat e personave me paftësi intelektuale çdo ditë, motivon përkushtimin më të madh në këtë luftë të përditshme. Mirënjohja e prindërve është gjithashtu motivim. Të gjithë së bashku po luftojmë, që të arrijmë nivel të kënaqshëm të përfshirjes sociale. Disa njerëz dinjë se si ta çmojnë këtë.”



ANITA GAGOVSKA,
Koordinatorë e Projektit
“Le të zhvillojmë shkathtësi të reja” PORAKA NOVA

QËNDRIM NGA BE-ja: Të Drejtat e Njeriut

Sipas Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, askush nuk guxon të diskriminohet për asnjë arsye, nuk guxon t'i nënshtrohet asnjë përvojë të dënimit ose degradimit johuman. Ashtu si të gjithë njerëzit, personat me paftësi intelektuale kanë lindur të lirë, me të drejta të barabarta dhe dinjëtet. Shtetet kanë obligim t'i mbrojnë ata nga trajtimet degraduese. BE-ja ndalon të gjitha format e diskriminimit, kurse vendet kandidatë për anëtarësim duhet doemos t'i plotësojnë këto kushte dhe të harmonizojnë legjislativonin e tyre me atë të BE-së.

http://ec.europa.eu/justice_home/fsj/rights/fsj_rights_intro_en.htm

Dogana moderne për shërbime kualitative

Shërbimi i sotëm modern doganor përballet me detyra fiskale (grumbullimin e obligimeve doganore, tatimeve direkte dhe indirekte) dhe jofiskale (mbrojtjen e qytetarëve nga importi i produkteve të dëmshme, të rrezikshme dhe të falsifikuara dhe mbrojtjen e mjedisit). Objektiva kryesore e mbështetjes të Bashkimit Europian është krijimi dhe zhvillimi i shërbimit modern dhe krijimi i partneritetit të barabartë për ndërmarrjet që merren me tregti të jashtme. Po aq e rëndësishme është edhe mbrojtja e interesave fiskale dhe të sigurisë së shtetit, bashkëpunimi me shërbimet e tjera qeveritare dhe përgatitja e Doganës për instalimin e rrjetit të plotë kompjuterik dhe këmbimin e informatave me shërbimet adekuate të BE-së. Projekti “Përforcimi i Kontrollit Kufitar” është shenjë e qartë e ndihmës së vazhdueshme

të BE-së për zhvillimin ekonomik të vendit, drejt rrugës për anëtarësim në BE, me anë të përkrahjes së vazhdueshme për reforma doganore.

Ky projekt, me vlerë prej 700,000 euro, është pjesë e Komponentit I, Ndhima e Tranzicionit dhe Ndërtimi Institucional, të programit IPA 2007. Qëllimi i tij kryesor është përdorimi i kontrolleve efikase doganore, lehtësimi i lëvizjes ligjore të mallërave dhe udhëtarëve, përmirësimi i grumbullimit nga të ardhurat dhe përforcimi i kapaciteteit administrativ të Administratës Doganore, në luftën kundër falsifikimit dhe korrupsionit.

Gjatë periudhës 18 mujore, projekti duhet të përmirësojë punën dhe kapacitetin administrativ të kontrollit kufitar dhe të organizojë aktivitetet promovuese për të stërvitur publikun dhe operatorët ekonomikë lidhur me

Emri i projektit:
Përforcimi i kontrollit kufitar

Sektori:
Unioni Tatimor dhe Doganor

Burimi i financimit:
IPA 2007

Vlera:
700,000 euro

Period:
2009-2011

Përfutues:
Administrata Doganore



zhvillimet e reja të funksionimit të Administratës Doganore. Nuk është më pak e rëndësishme as edhe ndihma që do të ofrojë për Administratën Doganore në përgatitjen e analizës të pajisjes për kontrollin kufitar.

Projekti ka për qëllim përkrahjen e reformave që po bëhen në Administratën Doganore dhe përmirësimin e efikasitetit organizativ dhe operativ të shërbimit doganor. Për të arritur këto objektiva, projekti do të zhvillojë një strategji nacionale për përcaktimin e procedurave kufitare. Njëkohësisht do të prezantohet program për monitorimin dhe vlerësimin e efekteve të efikasitetit kufitar dhe analizën e rreziqeve.

Për t'u përgatitur për anëtarësim në BE, Administrata Doganore duhet t'i adaptohet dispozitave të legjislacionit Shengen. Për të arritur kontroll më të mirë, projekti parasheh përdorimin

e përmirësuar të qenve doganorë, teknologjitë dhe pajisjet e informimit. Këtu përfshihen skanerët dhe pajisjet e tjera që zbulojnë mashtrimet në kalimet kufitare. Pajisja e blerë për përmirësimin e funksionimit kufitar, me vlerë prej 300,000 euro dhe e financuar nga Programi IPA 2007, duhet të shtojë kontrollin e mallërave dhe udhëtarëve në kalimet kufitare, si dhe të lehtësojë dhe të përshpejtojë lëvizjen e tyre. Qëllimi përfundimtar është të sigurohet se të gjithë personat që e kalojnë kufirin dhe mallërat që transportohen përmes territorit doganor të vendit, gëzojnë komfortin e njejtë dhe shërbimet e njejtë kualitative, si që do ta kenë në momentin e anëtarësimit në zonën doganore europiane. Ndërkohë, ndërmarrjet në vend duhet të përfitojnë nga lëvizja më e shpejtë e mallërave dhe kursimi i kohës dhe parave.

Harmonizimi me legjislacionin european

Krahas këtij projekti, në vitin 2009 filluan edhe dy projekte të financuara nga IPA 2007, të cilat gjithashtu janë paraparë të zgjasin 18 muaj. Projekti "Harmonizimi i mëtejshëm i Legjislacionit Doganor Nacional me Legjislacionin Doganor të Bashkimit European", me vlerë prej 1 milion euro, përfshin këshilla të ekspertëve doganorë të BE-së.

"Përmirësimet e Sistemeve Doganore të Teknologjive të Informimit" është projekti i tretë, me vlerë 700,000 euro, i cili ka paraparë përfundimin e kapaciteteve të Sektorit të Teknologjive të Informimit dhe të ndihmojë në përgatitjen e projekteve të Teknologjive të Informimit që janë të obligueshme për anëtarësimin në BE.

REZULTATET E PARAPARA:

- Kontrolli i drejtë, sistematik dhe efikas në kalimet kufitare
- Lehtësimi i tregtisë dhe sigurimi më i madh në linjat e furnizimit
- Lëvizja më e shpejtë e mallërave dhe udhëtarëve
- Procedurat më të lira dhe më të mira doganore

"Fondet IPA janë vërtetuar si mjet i dobishëm që i ndihmon Administratës Doganore në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin European. Puna e doganës, si në BE ashtu edhe në vendin tonë, është proces që ndryshon dhe përmirësohet vazhdimisht. Ndihma IPA është jashtëzakonisht e rëndësishme në përgatitjen dhe adaptimin e tërë sistemit doganor me atë të Europës, si dhe adaptimit të kushteve pas anëtarësimit në BE. Sfidat e vërteta janë akoma përpara nesh – implementimi i Kodeksit të ri Doganor, lidhja dhe funksionimi i ndërsjellë me sistemet kompjuterike doganore të BE-së. Projektet IPA kanë sjellur disa ndryshime të rëndësishme në shërbimin doganor, dhe kjo do të vazhdojë me siguri edhe në vitet që vijnë."



ZLATKO VETEROVSKI,
Shef i Departamentit për Trajnim, Administrata Doganore

QËNDRIM NGA BE-ja:

Unioni Doganor është element themelor në funksionimin e tregut unik. Mund të funksionojnë në mënyrë adekuate vetëm përmes zbatimit kolektiv të rregullave të përbashkëta në kufijtë e jashtëm të Bashkimit European. Deri vonë, roli i doganës ishte kryesisht grumbullimi i obligimeve doganore gjatë importimit. Sot, dogana luan rol në lehtësimin e tregut dhe mbrojtjen e interesave të Bashkimit European dhe qytetarëve të tij, nga kërcënimet terroriste dhe krimi i organizuar ndërkombëtar.

http://ec.europa.eu/taxation_customs/index_en.htm

Rritja e besimit në gjyqësi

Një nga themelet e shoqërisë moderne demokratike është ndjenja se drejtësia ekziston dhe se ka institucione që do ta mbrojnë dhe implementojnë atë. Në mungesë të sistemit funksional dhe profesional ligjor, asnjë vend nuk ka ardhmëri, sidomos jo përbrenda kornizës së Bashkimit Europian.

Sistemi ligjor i vendit përballet me një varg problemesh dhe riorganizimi i tij është ndoshta detyra më e vështirë në plotësimin e standardeve europiane, si parakusht për anëtarësimin e suksesshëm në familjen europiane.

Reforma gjyqësore ka qënë një nga prioritetet kryesore të ndihmës së Bashkimit Europian përmes Programeve IPA të viteve 2007, 2008, 2009 dhe 2010, me vlerë të përgjithshme 8,700,000 euro. Aktualisht, në suaza të Programeve IPA 2007 dhe 2008 ka tre projekte në fushën e gjyqësisë, me vlerë prej mbi se 2,500,000 euro, kurse

dy të tjera planifikohen për ciklin e Programeve IPA 2009 dhe 2010, me vlerë rreth 6,100,000 euro.

Aktivitetet e projektit “Përforsimi i mëtejshëm i Kapaciteteve Institucionale të Akademisë për Trajnim të Gjykatësve dhe Prokurorëve”, filluan në maj 2010 dhe parashihet të zgjasin 20 muaj. Me ndihmën nga BE-ja prej mbi 850,000 euro, synohet përmirësimi i sistemit trajnues, themelimi i sistemit “e-mësim”, zhvillimi i mekanizmave për trajnim të decentralizuar dhe përmirësimi i bibliotekës dhe faqes së internetit të Akademisë.

Projekti “Implementimi i Reformave në Drejtësinë e të Rinjve” filloi në prill 2010 dhe do të zgjasë 24 muaj. Ndihma e BE-së prej 700,000 euro duhet të kontribuojë jo vetëm në përforsimin e kornizës ligjore për implementimin efiikas të normave dhe standardeve të pranuar ndërkombë-

Emri i projektit:
Ndihmë për funksionimin më efiikas, më të efektshëm dhe modern të Gjykatës Administrative

Spektori:
Gjyqësia dhe Punët e Brendshme

Burimi i financimit:
IPA 2007

Vlera:
1,083,000 euro

Periudha:
2010-2011

Përfitues:
Gjykata Administrative dhe Ministria e Drejtësisë

tarisht për drejtësinë e të rinjve, edhe përditësimin e njohurive specialiste të gjykatësve dhe prokurorëve në këtë fushë, por gjithashtu edhe në përforsimin e kapaciteteve të qendrave për mirëqenie sociale që merren me kundërvajtësit e rinj.

Mbrojtja e të drejtave dhe interesave të qytetarëve

Qasja më e shpejtë dhe më kualitative në drejtësi, e cila çon drejt besimit më të madh në sistemin ligjor dhe mbrojtje më të madhe të të drejtave dhe interesave të individëve dhe entiteteve ligjore, është qëllimi i projektit për përkrahjen e funksionimit më efikas të Gjykatës Administrative. Me këtë projekt, Gjykata Administrative, si një nga gjykatat relativisht të reja të sistemit gjyqësor të vendit, do të fitojë ndihmë për zhvillimin e mëtutjeshëm të

kapaciteteve dhe sistemit të vet menaxhues. Përmes ndihmës së projektit, Gjykata Administrative do të mund të trajtojë numër plotësues të gjykatësve dhe ndihmësve ekspertë. Përmirësimi i sistemit të Teknologjive të Informimit të Gjykatës do të përshpejtojë dhe lehtësojë punën e gjykatësve, ndihmësve ekspertë dhe administratës gjyqësore.

Projekti parashihet me buxhetin e programit IPA 2007, me rreth 1,000,000 euro, me fillim të projektit në dhjetor 2009 dhe përfundim në dhjetor të vitit 2011.

Gjatë kësaj periudhe, pritet që projekti të përkrahë zhvillimin e sistemit më efikas gjyqësor dhe të menaxhimit të rasteve, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe përvojat më të mira europiane, duke pasur parasysh se rezultati i rasteve administrative ka ndikim të rëndësishëm në funk-

sionimin e sistemit të përgjithshëm administrativ publik dhe në besimin e qytetarëve për gjyqësinë. Për më tepër, në rastet ku qytetarët fillojnë procese gjyqësore kundër akteve administrative të institucioneve shtetërore, është jashtëzakonisht me rëndësi të kihet gjykatës me eksperiencë, të cilët mund të vlerësojnë ndikimin e ardhshëm të vendimeve jashtë margjinave të rasteve individuale.

Qëllimet e këtyre projekteve janë ambicioze, mirëpo përcaktimi i qëllimeve me standarde të larta është fundamental për të gjitha reformat dhe element i pazëvendësueshëm për procesin e fitimit të besimit të qytetarëve në gjyqësi. Edhe nëse arritja e këtyre synimeve kërkon përpjekje të mëdha nga të gjitha palët e involvuara, duhet të pranojmë se më në fund të gjithë do të përfitojnë nga ato.

REZULTATET E PARAPARA:

- Përmirësimi i implementimit të legjislacionit për konflikte administrative dhe vënia në fuqi e vendimeve të Gjykatës Administrative
- Përforsimi i kapacitetit organizativ të Gjykatës Administrative, duke u fokusuar në menaxhimin e gjykatave dhe resurseve njerëzore
- Rritja e shkathtësive profesionale të personelit të Gjykatës Administrative
- Përmirësimi i sistemit të Teknologjive të Informimit, sidomos në lidhje me lidhshmërinë reciproke të Gjykatës Administrative dhe organeve të tjera shtetërore

“Kontestet administrative, të cilat i trajton Gjykata Administrative, janë mënyra më e mirë dhe më përfituese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Efikasiteti më i madh dhe përmirësimi i kualitetit të vendimeve të Gjykatës do t’u ofrojnë qytetarëve dhe ndërmarrjeve, standarde më të larta të kontrollit gjyqësor mbi ligjshmërinë e punës së qeverisë, ministrive, administratës shtetërore dhe vetqeverisjes lokale.



BORIVOJ KOS,
Udhëheqës i Projektit për Gjykatën Administrative

QËNDRIM NGA BE-ja:

Ligji i Bashkimit European

Ligji i Bashkimit European, i cili është cituar edhe në Traktatin e Lisbonës, përmes legjislacionit të vet qytetarëve duhet t’u sigurojë liri, siguri dhe drejtësi. Është legjislacioni që doemos duhet të tregojë sukses në vendet ku përdorimi i forcës ka dështuar vite me radhë. Uniteti i vetëm që ka shpresa të mbijetojë është ai që bazohet në vendime të lira. Është lloji i unitetit që ndërtohet në vlerat siç janë liria dhe barazia, të cilat mbrohen dhe implementohen në jetën e përditshme, përmes legjislacionit.

http://ec.europa.eu/justice_home/fsj

Inovacioni në afarizëm: kërcim përpara

Pa inovacionet në prodhimtari, shërbime dhe në marketing, nuk do të kishte kërcim përpara në prodhimtarinë industriale e as zhvillim të shpejtë ekonomik. Ndërmarrjet që duan të hapërojnë me kohën dhe të adaptohen me kushtet aktuale ekonomike, por gjithashtu edhe të ecin përpara në zhvillim, shpesh nuk kanë strategji, vizion, planifikim, analizë të tregut dhe konkurrencës, as edhe këmbëngulësi, mprehtësi, vazhdimësi dhe motivim. Qëllimi i Programit TAM "Turn Around Management", është t'u ndihmojë ndërmarrjeve të shndërrohen në firma efikase dhe mirë të menaxhuara, të cilat mund të funksionojnë suksesshëm në ekonominë e tregut. TAM përkrah ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vendet ku operon Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD). Për Programin punojnë ekspertivë dhe menaxherë me përvojë, nga vendet e zhvilluara, dhe detyra e tyre

është transferimi i njohurive të tyre teknike dhe të tregut. Në periudhën 18 mujore të kohëzgjatjes së çdo projekti, ekspertët TAM vizitojnë ndërmarrjen 15 herë. Gjatë kësaj periudhe, ata ndihmojnë në rritjen e shitjeve, riorganizimin e strukturës organizative, menaxhuese dhe të marketingut të ndërmarrjes, të tejkalojnë problemet që mund të paraqiten në kushte të vështira të punës, si dhe të zgjidhin probleme teknike dhe çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e produktit. Programi TAM funksionon në vend që nga viti 1997, dhe gjatë kësaj kohe janë përfunduar 50 projekte. Programi i fundit, i financuar nga BE-ja në bashkëpunim me EBRD-në dhe me vlerë 700,000 euro, filloi në tetor 2006, zgjati deri në prill 2009 dhe u ndihmoi 13 ndërmarrjeve.

Të inkurajuar nga rezultatet e arritura gjatë Programit të kaluar TAM dhe me kërkesën e vazhdueshme të

Emri i projektit:
Programi TAM

Sektori:
Industria dhe sipërmarrësia

Burimi i financimit:
CARDS 2006

Vlera:
700,000 euro

Periudha:
2006-2009

Përfitues:
Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme



ndërmarrjeve lokale, BE-ja ka ndarë 1,000,000 euro nga IPA 2008 për financimin e Programit të ri TAM. Gjatë 2 viteve të ardhshme, rreth 20 ndërmarrje duhet të përfitojnë nga ndihma direkte që ofrojnë Ekzekutivët Kryesorë me përvojë dhe konsulentët ndërkom-bëtarë.

Përvoja pozitive

Përvoja e ndërmarrjes "Rade Konçar" me programin TAM ishte jashtëzakonisht pozitive. Dy ekspertët, njëri për marketing dhe tjetri për prodhimtari dhe organizim të prodhimtarisë, siguruan ekipin menaxhues se qëllimet dhe analizat e ndërmarrjes janë në rrugë të drejtë. Ndërmarrja, e cila punon nga viti 1948, përballej me problemin e ndër-

prerjes të prodhimeve të vjetra, si dhe kishte filluar përpjekjet për të mbyllur prodhimin e disa prej tyre. Në rrethana ku tregu i vjetër i ndërmarrjes në terri-toret e ish federatës ishte "shkatërruar" dhe kërkoheshin tregje të reja, trajnimi i marketingut për mënyrën e qasjes të konsumatorëve të rinj ishte shumë i dobishëm. Gjatë seancave që zgjatën katër javë me ekspertët e TAM-it midis vitit 2007 dhe fundit të vitit 2008, të punësuarit në departamentin e marketingut fituan njohuri të reja se si t'i qasen problemin në mënyrë moderne europiane dhe se sit ë përdorin më tepër format elektronike të marketingut. Krahas prezantimit të teknikave të marketingut, 14 të punësuarit që morën pjesë në trajnim, morën këshilla për mënyrën e parandalimit falsifikimit e prodhi-

meve të ndërmarrjes së tyre, si dhe mënyrën për t'iu kundërvënë konkurrencës. Pasuan rezultate. Prodhim-taria është shtuar, kurse transmetuesit dhe prizat elektrike "Rade Konçar" tani më gjenden në tregjet e reja në mbarë botën. Si plotësues i TAM-it është edhe Programi për Shërbim Këshilldhënës Afarist (BAS). Ky program zakonisht zgjat rreth katër muaj, gjatë të cilës kohë ekipet punojnë në fushën e hulumtimeve dhe analizën e tregut, zhvillimin e brendeve, modernizimin e sistemeve TI, prezantimin e sistemeve të menaxhimit të kualitetit dhe konsultimet teknike. Që nga fillimi i aktiviteteve të veta në 2002, BAS-i ka përkrahur mbi se 300 ndërmarrje në vend, duke u ndihmuar atyre të kuptojnë se mbijetesa dhe zhvillimi janë në duart e tyre.

REZULTATE:

- Rritja e shitjes në "Mebel" AD, "Mlin Stojçev"AD, "Inex Zorev"AD, C&B Sus, TING Doel dhe MZT Këpuçë
- Riorganizimi i rëndësishëm i strukturave organizative, menaxhuese dhe të marketingut "Frotirka"AD, "Bllagoj Gjorev"AD, "11 Oktomvri"AD dhe "Rade Konçar"AD
- Përkrahje për zgjidhjen e problemeve që dalin nga rrethanat e vështira ekzistuese në "Fatina"AD dhe "Dekon"AD
- Ndihmë në përgjigjen e pyetjeve të specializuara teknike dhe pyetjeve lidhur me zhvillimin e produkteve në fabrikën e prodhimeve të qumshit "Zdravje Radovo"

• *"Patëm sukses të vërtetojmë filozofinë dhe strategjinë tonë të vazhdueshme të prodhimit, e cila koincidoi plotësisht me rekomandimet e ekipit të ekspertëve TAM, të angazhuar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Kjo na nxiti të vazhdojmë dhe të insistojmë drejt qëllimeve tona të përcaktuara të prodhimit. Njëkohësisht, kuadrot komerciale u pajisën me njohuri të reja marketingu në fushën e segmentimit dhe pozicionimit të tregut, duke përdorur teknika dhe mjete marketing, si dhe në krijimin dhe përforsimin e brendit, përdorimin e trekëndëshit MëKarthis në përpunimin komercial të tregut, theksimi i përparësive krahasuese mbi konkurrencën dhe në përgatitjen e diskutimeve kreative komerciale"*



• **ALEKSANDAR JANÇIQ,**
Drejtor i D.o.o Kontaktori i relei, Shkup

QËNDRIM NGA BE-ja:

Rëndësia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Në Bashkimin European ka pothuajse 20 milionë ndërmarrje të vogla dhe të mesme, të cilat përfaqësojnë 99 përqind të të gjitha bizneseve. Ato janë çelsi i zhvillimit ekonomik, inovacionit, punësimit dhe integrimit social. Me këtë Bashkimi European synon të promovojë sipërmarrësinë e suksesshme dhe të përmirësojë klimën afariste për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe t'u mundësojë atyre të kuptojnë plotësisht potencialin e vet përbrenda kornizës së ekonomisë së sotme globale.

http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sme/index_en.htm

Tatimet në dobi të qytetarëve

Përmirësimi i punës së Ministrisë të Financave dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike, për grumbullimin e tatimeve, sigurimi i shërbimeve për taksapaguesit, përforsimi i kapacitetit institucional për grumbullimin e tatimeve dhe lufta kundër korrupsionit janë objektivat kryesore të projektit Përkrahja e Reformës Tatimore. Në periudhën 18 muajshe të kohëzgjatjes së projektit, korniza legale vendore do të harmonizohet me rregullat, direktivat, standardet dhe masat e Bashkimit Europian. Përkrahja e drejtpërdrejtë këshilldhënëse dhe ndihma teknike do të sigurojnë përshejtimin dhe vazhdueshmërinë e ndihmës aktuale për reformën e tatimeve. Qëllimi është t'i ndihmohet Ministrisë së Financave të përgatisë dy propozim ligje në fushën e vënies së drejtëpërdrejtë të tatimeve dhe vënien në fuqi të legjislacionit tatimor, njëkohësisht duke përkrahur

përforsimin e kapacitetit administrativ dhe operativ të Drejtorisë së të Ardhurave Publike. Këto janë dy projektet me vlerë 1,300,000 euro, të financuara nga Bashkimi Europian, përmes programit IPA 2007. Përbrenda kornizës të komponentit të parë, ekipi i ekspertëve i ndihmuar nga Departamenti Tatimor i Ministrisë së Financave, është duke punuar në vlerësimin e kornizës aktuale ligjore, sidomos në fushën e vënies direkte të tatimeve. Përgatitja e propozim ligjeve mbi tatimin nga përfitimi për ndërmarrjet dhe tatimi i të ardhurave personale për qytetarët, është rezultat i vlerësimit gjithëpërfshirës dhe të hollësishëm të legjislacionit, i sqarimit të direktivave europiane dhe i analizës krahasuese të politikave të Shteteve Anëtare, të cilat kanë të bëjnë me vënien e drejtëpërdrejtë të tatimit. Në periudhën e njëjtë, vlerësimet janë duke u realizuar në ndryshime të tjera

Emri i projektit:
Përkrahje e reformës tatimore

Sektori:
Politika tatimore

Burimi i financimit:
IPA 2007

Vlera:
1,300,000 euro

Periudha:
2010-2011

Përfitues:
Ministria e Financave dhe Drejtoria e të Ardhurave Publike



legjislative, ndërsa po organizohen programe trajnimi dhe punëtori lidhur me implementimin e legjislativës së re.

Standardet profesionale në Drejtorinë e të Ardhurave Publike

Paralelisht me harmonizimin e legjislacionit, është duke u punuar edhe në përfundimin e kapacitetit administrativ të Drejtorisë për të Ardhura Publike, si komponent i dytë i projektit. Gjatë zhvillimit të strategjisë dhe planeve konsekuente për realizimin e qëllimit, prioritetet u jepet sektorëve me standarde profesionale, revizionit të brendshëm, inspektionit tatimor, si dhe përkrahjes së kapaciteteve për të luftuar korrupsionin. Ky projekt gjithashtu përfshin

sektorët e grumbullimit të detyruar të tatimeve, komunikimit me taksapaguesit, trajnimin e menaxherëve dhe përmirësimin e përgjithshëm të shërbimeve për taksapaguesit. Përfundimi i kapacitetit administrativ të kësaj Drejtorie do të mundësojë implementimin e legjislacionit tatimor dhe luftën më efektive kundër bishtnimit të tatimeve, gjë që do të përfundojë politikën fiskale dhe do të inkurajojë investimet vendore dhe të huaja në përgjithësi. Në kuadër të projektit është paraparë analiza e hollësishme mbi mundësinë e bashkimit të policisë financiare nga Ministria e Financave me Drejtorinë e të Ardhurave Publike, si dhe themelimi i departamentit të ri që do të merret me rastet e ndërlukuara tatimore, rastet

e shmangies së tatimeve dhe me strategjinë e luftimit të ekonomisë jozyrtare. Krahas projektit për Ndhimë Teknike, është rinovuar godina e Drejtorisë së të Ardhurave Publike për taksapaguesit e vegjël dhe të mesëm në qytetin e Shtipit, e cila edhe është pajisur me sistem modern të Teknologjive të Informimit. Këto aktivitete synojnë përmirësimin e shërbimeve ndaj taksapaguesve të vegjël dhe të mesëm, me ngritjen e vetëdijes mbi obligimet tatimore dhe rritjen e grumbullimit të tatimeve. Për këtë qëllim, godina e Drejtorisë në Shtip, u rinovua në pajtim me standartet Europiane dhe kushtoi rreth 79,000 euro. Me shumën prej 245,000 euro u blenë dhe u instaluan 273 kompjuterë, dy stacione grafike dhe 30 printerë.

REZULTATET E PRITURA:

- Hartimi i propozim ligjeve të reja mbi tatimin e të ardhurave dhe tatimin nga përfitimi
- Ndryshimet në politikën ligjore me qëllim të harmonizimit me legjislacionin europian
- Vlerësimi i strukturave ekzistuese ligjore, organizative dhe institucionale, politikave dhe procedurave në Drejtorinë e të Ardhurave Publike dhe propozimet për përmirësimin e kapacitetit administrativ
- Përfundimi i funksionit të revizionit të brendshëm
- Komunikimi efikas në pajtim me planet fiskale të BE-së
- Shërbime më të mira për taksapaguesit
- Përfundimi i departamenteve përgjegjëse për taksapaguesit e vegjël dhe të mesëm në drejtoritë rajonale të Drejtorisë për të Ardhura Publike, në Shtip dhe në Tetovë.

“Me implementimin e këtij projekti, BE-ja njeh rëndësinë e legjislacionit tatimor, i cili, varësisht nga faktorët e ndryshëm politik, shpesh i nënshtrohet ndryshimeve. Si rezultat i këtij projekti, parashohim harmonizimin e plotë të legjislacionit që ka të bëjë me vënien e drejtpërdrejtë të tatimit me Direktivat e BE-së dhe rregullat që drejtojnë tregun e përbashkët të BE-së. Ne gjithashtu shpresojmë të kemi ligje gjithëpërfshirëse që do të përmirësojnë procedurat administrative, shërbimet e taksapaguesve dhe përfundimin e funksionit të përgjithshëm të sistemit tatimor në vend.”



BORCE SMILEVSKI,
Shef i Departamentit Tatimor,
Ministria e Financave

QËNDRIM NGA BE-ja:

Strategjia e politikës tatimore

Komisioni Europian ka përgatitur strategji të përgjithshme për politikën tatimore të Bashkimit Europian. Komisioni Europian beson se politika tatimore duhet t'i përkrahë synimet më të mëdha të politikës së BE-së, siç është qëllimi i Bashkimit Europian për t'u bërë ekonomia më konkurruese në botë. Veç kësaj, politika tatimore duhet të përputhet me politikat e tjera të BE-së. Qëllimi i Komisionit Europian është t'i kushtojë më tepër vëmendje problemeve tatimore të individëve dhe ndërmarrjeve që punojnë në suaza të tregut të brendshëm, si dhe të thjeshtësojë sistemet tatimore dhe t'i bëjë më të kuptueshme për taksapaguesit.

http://ec.europa.eu/taxation_customs/taxation/gen_info/tax_policy/index_en.htm

Burime të ngjashme onlajn

BASHKIMI EUROPIAN

EUROPA: Hyrja në Bashkimin European
www.europa.eu

Komisioni European
www.ec.europa.eu

Drejtoritë Gjenerale dhe Shërbimet e Komisionit
www.ec.europa.eu/dgs_en.htm

Delegacioni i Komisionit European
www.delmkd.ec.europa.eu

Qendra Informative e BE-së
www.euic.mk

POLITIKAT E BE-së

Ekonomi dhe financa
www.ec.europa.eu/economy_finance

Konkurrenca
www.ec.europa.eu/dgs/competition

Tregu dhe shërbimet e brendshme
www.ec.europa.eu/dgs/internal_market

Ndërmarrja dhe industrinë
www.ec.europa.eu/enterprise

Bujqësia dhe zhvillimi rural
www.ec.europa.eu/dgs/agriculture

Deti dhe peshkataria
www.ec.europa.eu/dgs/fisheries

Mjedisi
www.ec.europa.eu/dgs/environment

Shërbimi shëndetësor dhe mbrojtja e konsumatorëve
www.ec.europa.eu/dgs/health_consumer

Shëndeti publik
www.ec.europa.eu/health-eu/health_problems

Energjia dhe transporti
www.ec.europa.eu/dgs/energy_transport

Drejtësia, liria dhe siguria
www.ec.europa.eu/dgs/justice_home

Arsimi dhe kultura
www.ec.europa.eu/dgs/education_culture

Politika rajonale
www.ec.europa.eu/dgs/regional_policy

Puna kërkimore
www.ec.europa.eu/dgs/research



Delegacioni i Bashkimit European

www.delmkd.ec.europa.eu